



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

lidhur me vizitat në pikëkalimet kufitare dhe në stacionet policore për mbikëqyrje si në vijim:

- *Pikëkalimi Kufitar “Kulla”*
- *Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Radac*
- *Pikëkalimi Kufitar në Merdare*
- *Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Jarine*
- *Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjelhër në Kllokot*
- *Pikëkalimi Kufitar Stançiq – Bellanoc*
- *Pikëkalimi Kufitar në Vërmicë*
- *Pikëkalimi Kufitar Dheu i Bardhë*

Drejtuar: Z. Xhelal Sfeçla, ministër
Ministria e Punëve të Brendshme
Z. Gazmend Hoxha, drejtor i përgjithshëm
Policia e Kosovës
Z. Fehmi Xhata, drejtor
Policia e Kosovës, Departamenti për Kufi

Kopje: Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 5 mars 2025

Hyrje

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit (MKP) ka vizituar pikëkalimet kufitare dhe stacionet policore për mbikëqyrje të Vijës së Gjelbër të Kufirit, si në vijim:

- më 27 shkurt 2024 është vizituar Pikëkalimi Kufitar Kulla;
- më 27 prill 2024 është vizituar Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit – Radac;
- më 20 mars 2024 është vizituar Pikëkalimi Kufitar në Merdare;
- më 23 korrik 2024 është vizituar Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit – Jarine (SPMK);
- më 24 korrik 2024 është vizituar Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjelbër në Kllokot;
- më 25 korrik 2024 është vizituar Pikëkalimi Kufitar Stanqiq – Bellanoc;
- më 20 shtator 2024 është vizituar Pikëkalimi Kufitar në Vërmicë;
- më 2 tetor 2024 është vizituar Pikëkalimi Kufitar Dheu i Bardhë.

MKP-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, institucionet psikiatrike dhe të kujdesit social.

Të gjitha vizitat në pikat e lartpërmendura janë realizuar së bashku me UNHCR-në dhe me CRP/K-në, me të cilat Avokati i Popullit ka marrëveshje bashkëpunimi.

Qëllimi i vizitës

1. Qëllimi i vizitës në pikëkalimet kufitare ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve dhe të të ndaluarve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale, me Ligjin nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria e tyre. Gjatë vizitave në pikëkalimet kufitare në fjalë, përveç vlerësimit të përgjithshëm të respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve dhe të të ndaluarve, vëmendje u janë kushtuar edhe shumë çështjeve të tjera të rëndësishme, që kanë të bëjnë me kushtet e punës në të cilat punojnë zyrtarët policorë, numrin e stafit, e të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në kryerjen e punës së përditshme etj.

Bashkëpunimi me MKP-në gjatë vizitave

2. Gjatë vizitës në pikëkalimet kufitare të lartpërmendura, Policia e Kosovës i ofroi MKP-së bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat në çdo pikëkalim kufitar. Ekipyt iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe qasje në të gjitha dokumentet e kërkuara.

Garancitë kundër keqtrajtimit

3. Të drejtat e personave të arrestuar nga Policia e Kosovë janë të përcaktuara dhe të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Kodin e Procedurës Penale dhe me instrumentet ndërkombëtare.
4. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), në raportin e 2-të të Përgjithshëm, i publikuar në vitin 1992, ka theksuar rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia, të cilat janë: e drejta për ta njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin (anëtarin e familjes, mikun, konsullatën); e drejta për të pasur një avokat; e drejta për t'u ekzaminuar nga mjeku sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor nga një mjek i thirrur nga autoritetet policore).¹
5. Sipas KPT-së, këto të drejta janë garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik dhe duhet të zbatohen që nga momenti i parë i privimit nga liria, pa marrë parasysh se si përcaktohet në kuadër të sistemit ligjor të një vendi.
6. Legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës këto të drejta themelore të personave të arrestuar dhe në mbajtje nga autoritetet policore i parasheh edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Kodin e Procedurës Penale dhe në Ligjin për Policinë.
7. Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se çdo person i privuar nga liria duhet të njoftohet menjëherë, në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton, për të drejtën për ndihmë juridike sipas dëshirës së tij, për të drejtën për t'i njoftuar anëtarët e familjes apo ndonjë person tjetër për faktin që është arrestuar dhe se këto të drejta aplikohen gjatë gjithë kohës së privimit nga liria.
8. Për sa i përket njoftimit për arrestim, neni 168 i Kodit të Procedurës Penale më tej përcakton se personi i arrestuar ka të drejtë ta njoftojë anëtarin e familjes apo personin tjetër, sipas përzgjedhjes së tij, për arrestimin dhe vendin e ndalimit menjëherë pas arrestimit; njoftimi i familjarit apo i personit tjetër lidhur me arrestimin mund të vonohet më së shumti deri në 24 orë kur prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetim të rastit. Kjo vonesë nuk aplikohet në rastin e personave të mitur.
9. Sipas Ligjit për Policinë², e drejta për ta njoftuar familjen apo personin tjetër për arrestimin gjithashtu vlen edhe për personat të cilët janë në “*ndalim të përkohshëm*”, me qëllim të identifikimit ose për shkak të mbrojtjes së tyre dhe mbrojtjes së të tjerëve.
10. Sipas Kodit të Procedurës Penale, neni 13, paragrafi 2.3, neni 163, paragrafi 2, neni 164, paragrafi 5, ndaj personave të dyshuar përcakton se koha e ndalimit policor në qendrat e ndalimit nuk duhet të kalojë më shumë se dyzet e tetë orë (48) nga koha e arrestimit të tij, përveç rasteve kur gjyqtari i procedurës paraprake urdhëron ndryshe.
11. Sipas nenit 60 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, ndalimi i të miturit nuk mund të kalojë periudhën njëzet e katër orë (24), dhe pas kalimit të kësaj periudhe, i mituri duhet të lirohet, përveç nëse gjyqtari për të mitur cakton paraburgim.³

¹ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f/>

² Ligji për Policinë, neni 20.

³ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 60.

12. Për sa i përket së drejtës për avokat, personi i ndaluar/arrestuar në bazë të nenin 166 të Kodit të Procedurës Penale, ka të drejtë për ndihmë të menjëhershme të mbrojtësit pas arrestimit të tij, sipas zgjedhjes së tij.⁴ Mirëpo kur pësoni i arrestuar nuk angazhon mbrojtës, atij i sigurohet mbrojtësi me shpenzime publike.⁵ Po ashtu, personi i ndaluar mund të heqë dorë nga ndihma e mbrojtësit, kjo e drejtë mund të hiqet në bazë të nenit 53, paragrafi 3, të Kodit të Procedurës Penale: *“Nga e drejta për të pasur mbrojtës mund të hiqet dorë, përveç në rastin e mbrojtjes së detyruar, nëse heqja dorë bëhet qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë për të drejtën e tij në mbrojtje. Heqja dorë duhet bërë me shkrim dhe duhet nënshkruar nga i dyshuari apo i pandehuri dhe nga organi kompetent që e zbaton procedurën, ose mund të bëhet gojarisht në audio apo videokasetë, autenticiteti i të cilës verifikohet nga gjykata.”*
13. Ndërsa personat nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare mund të heqin dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës me pëlqimin e prindit, të kujdestarit ose të përfaqësuesit nga qendra për punë sociale, përveç rasteve të dhunës në familje, në të cilat është përfshirë prindi ose kujdestari, raste këto të cilat prindi ose kujdestari i tillë nuk mund të japin pëlqim për heqjen dorë nga kjo e drejtë.⁶
14. Lidhur me të drejtën për kontroll mjekësor të personave të arrestuar/ndaluar, neni 169 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se personi i arrestuar/ndaluar ka të drejtë për kontroll mjekësor sipas kërkesës së tij të kontrollohet nga mjeku apo nga dentisti, sipas përzgjedhjes së tij.⁷ Po ashtu kur personi i arrestuar tregon shenja të sëmundjes mendore, policia menjëherë mund të urdhërojë kontrollimin nga një psikiatër.⁸
15. Ndërsa kur personi i arrestuar është shtetas i huaj, sipas nenit 167 të Kodit të Procedurës Penale, ka të drejtë ta njoftojë dhe të komunikojë gojarisht apo me shkrim me ambasadën, me zyrën ndërlidhëse apo me misionin diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është ai, ose me përfaqësuesin e organizatës kompetente kur ai është refugjatë ose nën mbrojtën e ndonjë organizate ndërkombëtare.⁹
16. Për sa i përket respektimit të dinjitetit njerëzor, sipas nenit 5, paragrafi 1, të Ligjit nr. 06/L-013 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-214, përcakton:
1. *Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar zyrtarët kufitar detyrohen që ta respektojnë dinjitetin njerëzor në veçanti, rastet ku përfshihen personat e cenusëm.*
17. Gjithashtu, sipas nenit 8, paragrafët 2 dhe 3, të Ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, përcaktohet:
2. *Autorizimet që i ndërmarrin zyrtarët policor kufitar gjatë kryerjes së kontrollit kufitar duhet të jenë në proporcion me qëllimin për të cilin ndërmerren.*

⁴ Kodi i Procedurës Penale, neni 166, paragrafi 1.

⁵ Kodi i Procedurës Penale, neni 166, paragrafi 2.

⁶ Kodi i Procedurës Penale, neni 53, paragrafi 5.

⁷ Kodi i Procedurës Penale, neni 169, paragrafi 1.

⁸ Kodi i Procedurës Penale, neni 169, paragrafi 4.

⁹ Kodi i Procedurës Penale, neni 167, paragrafët 1 dhe 2.

3. *Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar zyrtarët policor kufitar nuk bëjnë diskriminim lidhur me gjininë, përkatësinë etnike ose racore, moshën, statusin sociale, bindjen fetare, paaftësinë ose përcaktimin seksual, pozitën pronësore dhe shoqërore.*

18. Gjatë vizitave në pikëkalimet kufitare dhe në stacionet policore të lartcekura, MKP-ja nuk ka hasur në persona të arrestuar dhe të ndaluar.

Dosjet e të arrestuarve

19. Lidhur me evidencat, neni 56, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7 dhe 1.8, të Ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, përcaktohet:

“1.Policia kufitare është e autorizuar që për nevojat e kontrollit kufitar dhe punët tjera në pajtim me këtë ligj, të mbajë:

1.1.evidencë për personat dhe mjetet e transportit që i nënshtrohen kontrollit kufitar;

1.2.evidencë të personave të cilëve u është dhënë leje për kalimin e kufirit shtetëror jashtë pikave të kalimit kufitar dhe jashtë orarit të përcaktuar të punës në pikat e kalimit kufitar;

1.3.evidencë të lejeve të dhëna për futjen dhe mbajtjen e armës, municionit dhe pajisjeve në Republikën e Kosovës nga ana e pjesëtarëve të organeve të huaja të sigurisë;

1.4.evidencë të incidenteve të kryera kufitare;

1.5.evidencë për të dhënat personale të të punësuarve të operatori dhe personat tjerë juridike ose fizike të cilët në zonën e pikës kufitare kryejnë veprimtari;

1.6.evidencë për vizat e lëshuara në pikat e kalimit kufitar;

1.7.evidencë për lehtësimin e kontrollit kufitar; dhe

1.8.evidencë për refuzimin e hyrjes në kufi.”

20. Për sa u përket të dhënave personale, neni 54, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, përcakton:

“1. Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar dhe punëve tjera të përcaktuara me këtë ligj policia kufitare është e autorizuar që nga personat ndaj të cilëve i aplikon autorizimet policore, drejtpërdrejt të grumbulloj të dhëna personale që përpunohen në evidencat, me aplikimin e aparateve teknike në pajtim me këtë ligj, si dhe të shfrytëzojë të dhëna personale dhe të dhëna tjera nga evidencat që themelohen dhe mbahen në bazë të ligjeve tjera.

2. Policia kufitare detyrohet që grumbullimin, përpunimin dhe shfrytëzimin e të dhënave personale nga paragrafi 1. i këtij neni ta bëjë në pajtim me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.”

21. Për sa u përket të dhënave personale, neni 57, paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15, i Ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, përcakton:

1. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.1. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji, grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, të dhënat për dokumentin e udhëtimit ose dokumentin tjetër të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror me të cilin personi e ka kaluar kufirin shtetëror, fotografia e personit që e ka kaluar kufirin shtetëror, vendqëndrimi, shtetësia, vendi, koha dhe drejtimi.
2. Në evidencën nga nën-paragrafi 1.2. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendqëndrimi, shtetësia, lloji dhe numri i dokumentit në bazë të cilit është dhënë leja, shkaku për dhënien e lejes, vendi i kalimit të kufirit shtetëror dhe afati i vlefshmërisë së lejes.
3. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.3. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendqëndrimi, shtetësia, lloji dhe numri i dokumentit të udhëtimit dhe dokumentit tjetër të vlefshëm të përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror, lloji i armëve, pajisjes dhe numri i municionit.
4. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.4. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendqëndrimi, shtetësia, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së incidentit kufitar, lloji, numri dhe afati i vlefshmërisë së dokumenteve në bazë të të cilave është përcaktuar identiteti.
5. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.5. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi ose vendqëndrimi, shtetësia, data e fillimit dhe e ndërprerjes së punës në zonën e pikës kufitare, emri i personit tjetër juridik ose fizik tek i cili personi është i punësuar.
6. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.6. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi ose vendqëndrimi, shtetësia, llojin dhe kohëzgjatjen e vizës.
7. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.7. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri i pikës së kalimit kufitar e cila i nënshtrohet lehtësimit të kontrollit kufitar, koha kur ka filluar dhe kur ka mbaruar lehtësimi i kontrollit kufitar, arsyeja e zbatimit të lehtësimit të kontrollit kufitar dhe të dhënat e zyrtarit që ka urdhëruar lehtësimin e kontrollit kufitar. 18
8. Në evidencat nga nën-paragrafi 1.8. paragrafi 1. i nenit 56 te këtij ligji grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale në vijim: emri dhe mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi ose vendqëndrimi, shtetësia, llojin dhe kohëzgjatjen e vizës (nëse për hyrje kërkohet viza), vendi i fundit prej ku është nisur drejtim te Republikës së Kosovës, arsyeja e refuzimit, pika e kalimit kufitar ku është bërë refuzimi, ndalesa për hyrje, nëse aplikohet, dhe të dhënat e zyrtarit i cili e bënë refuzimin e hyrjes.

9. *Të dhënat personale nga evidenca nga paragrafi 1. i këtij neni ruhen pesë (5) vjet nga dita e shënimit.*
 10. *Të dhënat personale nga evidenca nga paragrafi 2. i këtij neni ruhen dy (2) vjet pas kalimit të kohës për të cilën është dhënë leja.*
 11. *Të dhënat personale nga evidenca nga paragrafi 3. i këtij neni ruhen tri (3) vjet nga dita e hyrjes së realizuar në territorin e Republikës së Kosovës.*
 12. *Të dhënat personale nga evidenca nga paragrafi 4. i këtij neni ruhen pesë (5) vjet nga dita e kryerjes së incidentit kufitar.*
 13. *Të dhënat personale nga evidenca nga paragrafi 5. i këtij neni ruhen dy (2) vjet nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në zonën e pikës kufitare.*
 14. *Të dhënat personale nga evidenca nga paragrafi 6. i këtij neni ruhen pesë (5) vjet nga dita e lëshimit të vizës në kufi.*
 15. *Të dhënat personale nga evidencat nga paragrafi 7. dhe 8. të këtij neni ruhen dy (2) vjet nga dita e zbatimit të lehtësimit të kontrollit kufitar përkatësisht nga dita e refuzimit të hyrjes.*
22. Lidhur me të dhënat personale, neni 58 i Ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, përcakton:
1. *Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kryen mbikëqyrjen, përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e tyre të përcaktuara me këtë ligj.*
23. Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar gjatë vizitave në pikëkalimet kufitare policore të lartpërmendura, MKP-ja ka vërejtur se të gjitha pikëkalimet kufitare të Policisë e posedojnë dokumentin standard (dosjen e të arrestuarit/ndaluarit), në të cilin regjistrohen të gjitha të dhënat lidhur me të arrestuarin, në pajtim me nenin 170 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, përveç Pikëkalimit Kufitar në Kullë, e cila nuk kishte regjistra për evidentimin e personave të ndaluar, duke përfshirë të dhënat, si: koha e mbajtjes, nacionaliteti, gjinia dhe mosha.
24. Përveç kësaj, MKP-ja ka vërejtur se në secilin pikëkalim kufitar të vizituar kishte dokumente konkrete shtesë, në të cilat autoritetet policore kishin evidentuar çdo ngjarje lidhur me personin e arrestuar. Po ashtu, MKP-ja ka hasur edhe në raste kur zyrtarët policorë, përgjegjës për qelitë e mbajtjes, me iniciativën e tyre kanë përpiluar program kompjuterik për mbajtjen e të dhënave për personat e arrestuar. Kjo praktikë nuk është unike në nivel të vendit.

Trajtimi

25. Gjatë vizitave në pikëkalimet kufitare të lartpërmendura, MKP-ja nuk ka hasur në persona të ndaluar dhe të arrestuar.

Kushtet fizike në këto pikëkalime kufitare

26. Procedura Standarde e Operimit përcakton se qendrat e ndalimit duhet të jenë në përputhshmëri me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe me Rekomandimet e Komitetit për Parandalim të Torturës duke u bazuar në

Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore Jonjerëzore dhe Poshtëruese.¹⁰

27. MKP-ja vëren se KPT-ja në raportin e 2-të të Përgjithshëm, i publikuar më 13 prill 1992, në Strasburg, ka përcaktuar standardin lidhur me kushtet në qelitë ku mbahen të arrestuarit, i cili përcakton: *“Të gjitha qelitë në stacione policore duhet të jenë të madhësisë së arsyeshme për numrin e personave të akomoduar, duhet të kenë ndriçim adekuat (shembull, dritë e mjaftueshme për të lexuar, me përjashtim të periudhave të fjetjes) dhe ventilim dhe të jenë të pajisura me karrige të fiksuar ose tavolinë). Për më shumë, personat të cilët qëndrojnë në ndalim gjatë natës duhet t’u sigurohen çarçafë dhe batanije të pastra.”*¹¹

28. MKP-ja vëren se sipas ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, neni 31, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, ka përcaktuar kushtet për ndërtim dhe rregullim, si në vijim:

1. *Objektet të cilat i shfrytëzon Ministria në pikat e kalimit kufitar duhet të planifikohen, ndërtohen dhe rregullohen në mënyrë që të mundësojnë kryerje të sigurt, të papenguar dhe ekonomike të kontrollit kufitar në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe aktet që i përcakton Qeveria e Republikës së Kosovës.*
2. *Operatori detyrohet që të sigurojë kushte përkatëse për punë, hapësire dhe objekte që mundësojnë kryerje të papenguar të kontrollit kufitar, në pajtim me këtë ligj.*
3. *Operatori i aeroporteve në të cilat zhvillohet komunikacioni ajror ndërkombëtar detyrohet që të krijojë kushte për vendosje të të huajve të cilët nuk i plotësojnë kushtet për hyrje në Republikën e Kosovës, si dhe të udhëtareve të cilët kalojnë transit nëpër territorin e Republikës së Kosovës.*
4. *Shpenzimet për sigurimin e kushteve dhe standardeve nga paragrafët 1., 2. dhe 3. të këtij neni dhe nga neni 22 i këtij ligji, janë në ngarkim të operatorit. 5. Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet operatoreve dhe organeve shtetërore kompetente lidhur me shfrytëzimin e lokaleve dhe objekteve të dedikuara për kryerjen e kontrollit kufitar rregullohen me marrëveshje.*

29. MKP-ja vëren se sipas Ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, neni 31, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, ka përcaktuar ndërtimin dhe vendosjen e objekteve dhe ndryshimi i veprimtarisë në zonën e pikëkalimit kufitar, si në vijim:

1. *Ndërtimi dhe vendosja e objekteve dhe ndryshimi i veprimtarisë në zonën e pikës se kalimit kufitar nuk mund të pengojnë kryerjen e detyrave dhe zbatimin e masave të sigurisë në kufirin shtetëror.*
2. *Kryerësi i veprimtarisë në zonën e pikës se kalimit kufitar detyrohet që veprimtarinë ta kryejë në lokale përkatëse të dedikuara për atë qellim.*
3. *Investuesi ose pronari i objektit, përkatësisht kryerësi i veprimtarisë detyrohet që para fillimit të aktiviteteve për ndërtim, vendosje të objekteve ose ndryshim të veprimtarisë të merr leje nga Ministria.*

¹⁰ Policia e Kosovës, Procedurat Standarde të Operimit për Qendrat e Ndalimit, DDO-04/0121/2016, pika 1.6, faqe 4.

¹¹ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 2-të i Përgjithshëm, paragrafi 42. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/1680696a3f>.

4. *Leja nga paragrafi 3. i këtij neni nuk do të lëshohet, nëse me objektin ose veprimtarinë pengohet kryerja e pandërprere e kontrollit kufitar dhe zbatimi i masave të sigurisë në kufirin shtetëror si dhe nëse nuk është në pajtim me planin urbanistik për pikën e kalimit kufitar përkatëse.*

30. Gjatë vizitës në **Pikëkalimin Kufitar Kulla**, MKP-ja ka vërejtur kushtet e papërshtatshme të punës. Vjetërsia e kontejnerëve, në të cilët operon stacioni policor, pasi këta kontejnerë janë vendosur më shumë se 20 vite më parë dhe mungesa e një objekti ka ndikuar që të mos ketë hapësirë të mjaftueshme për të kryerjen e detyrave të punës, e aq më tepër ku nuk kishte një dhomë të ndalimit. Gjithashtu stacioni nuk posedonte regjistra për evidentimin e personave të ndaluar, ku do të përcaktohej koha e mbajtjes, nacionaliteti, gjinia, mosha etj. Kushtet e punës në këtë pikë kufitare ishin shumë të vështira, pasi kontejnerët e vjetër nuk ishin të përshtatshëm për të ofruar ambient të nevojshëm për punë. Punonjësit që punojnë në këtë pikë kufitare përballen me të ftohtë (gjatë sezonit të dimrit) dhe nxehtësi të madhe (gjatë sezonit të verës), kishte mungesë uji, ndërsa ushqimi ishte një sfidë e madhe. Problem i madh është edhe mungesa dhe prishja e fotokopjeve për arsye se operatori ekonomik nuk u përgjigjet kërkesave për servisim të aparateve fotokopjuese deri në dy apo tre javë dhe kjo çon në vonesën e procedimit të raporteve dhe rasteve në Polici.

Punonjësit e Policisë në këtë pikëkalimi kufitar ndajnë të njëjtin objekt me doganierët.

31. Gjatë vizitës në **Stacionin për Mbikëqyrje të Kufirit – Radac**, MKP-ja ka vërejtur se objekti është ndërtim i ri, modern dhe që i plotëson të gjitha kushtet. Sipas zyrtarëve policorë, ky është një ndër stacionet më të mira në vend.

32. Gjatë vizitës në **Pikëkalimin Kufitar në Merdare**, MKP-ja ka vërejtur se objekti i përmbush të gjitha standardet e kërkuara, megjithatë u identifikua një problem me të cilin ballafaqohen zyrtarët policorë: furnizimin me ujë. Stacioni kishte dy dhoma të ndalimit, të cilat janë të dizajnuara për qëndrimin e përkohshëm të individëve për disa orë, kryesisht ata që ndodhen në Stop Listë. Në rast se një person ndalohej, njoftohen stacionet e tjera dhe personi transferohet brenda disa orësh. Nëse ndihma mjekësore është e nevojshme, ajo ofrohet nga Podujeva.

Dhomat e ndalimit ishin në gjendje të mirë, të pastra, me ajrosje dhe ndriçim të mjaftueshëm. Ato ishin të pajisura me ulëse dhe ishin nën mbikëqyrje nga kamerat e sigurisë. Në këtë stacion policor punojnë 45 zyrtarë policorë dhe të gjithë ishin meshkuj. Ndërsa, në rastet kur arrestohen femra, një police femër dërgohet nga Podujeva, për kontroll dhe bastisje. Mosha mesatare e zyrtarëve ishte mbi 50 vjeçare dhe ishin në pritje që të plotësohet me zyrtarë të rinj, pas përfundimit të trajnimeve përkatëse.

Në të njëjtin objekt ishin të vendosur edhe zyrtarët doganorë, të cilët, në kohën e vizitës nga ekipi, së bashku me zyrtarët e kontrollit në kabina, kryenin detyrat e tyre të përditshme.

33. Gjatë vizitës në **Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Jarine**, MKP-ja ka vërejtur se kushtet në të cilat punojnë zyrtarët policorë janë shumë të papërshtatshme. Zyrtarët ishin të vendosur në kontejnerë, ishin të vjetruar, me ndryshk, dyshemeja, e cila ishte nga druri, pothuajse ishte e kalbur, nuk kishte klimë (përveç asaj që ishte vendosur ditëve të fundit në zyrën e dispeçerit). Në zyrën e Komandantin ishte i vendosur një krevat dykatësh, ndërsa shtroja e mbuloja ishin të siguruara nga Policia e Kosovës. Pjesa

më e madhe e punës zhvillohej në kontejnerë të vendosur përkohësisht në vitin 2020. Stafi përfshinte 13 policë, prej tyre një femër, dhe kishin asistencë nga drejtoria kur ishte e nevojshme. Njësia për Ndërhyrje të Shpejtë (NJSh) operonte në afërsi të këtij pikëkalimi dhe është vënë në dukje bashkëpunimi i shkëlqyer me këtë njësi.

Pjesa më e madhe e stafit të Policisë është mbi 50 vjeç dhe nuk ka pasur prurje të oficerëve të rinj kohëve të fundit. Këta zyrtarë kanë në dispozicion mjetet e nevojshme për kryerjen e punëve, por kanë nevojë për furnizim të mëtejshëm me uniformë. Uji i pijshëm dhe ushqimi ofrohen nga Policia e Kosovës. Pas incidentit të bllokimit në Banjskë, vitin e kaluar, janë marrë masa dhe janë siguruar rezerva naftë, të cilat ishin të vendosur në afërsi të Njesisë për Ndërhyrje të Shpejtë, e cila po ashtu ishte e vendosur në kontejnerë.

Ekipi ka vazhduar edhe te kontejnerët ku ishte i vendosur Njësiti për Ndërhyrje të Shpejtë, ku gjendja ishte po ashtu jo e mirë dhe ku afër objektit ishin vendosur tre rezervuar me naftë. Sipas vlerësimit (laik) të MKP-së, përveç kushteve të rënda, edhe pozicioni i këtij stacioni nuk ishte i përshtatshëm dhe nuk kishte një rrjetë mbrojtëse mbi objektet, që do të ofronte siguri më të madhe.

Takimit në një drekë pune iu bashkua edhe Komandanti i Pikëkalimit Kufitar në Bërnjak, i cili po ashtu na njoftoi se janë të vendosur në kontejnerë dhe se ballafaqohen me të njëjtat probleme si në Jarinje. Moshja e shtyrë e zyrtarëve policorë, furnizimi me uniforma, kushtet e tjera të punës, sigurimi shëndetësor ishin ndër temat që u diskutuan.

34. Gjatë vizitës në **Stacionin Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjellbër në Kllokot**, ku Policia Kufitare është e vendosur së bashku me Policinë e Rendit, MKP-ja ka vërejtur se Policia Kufitare ka bashkëpunim të mirë me Policinë e Rendit. Stacioni Policor ka dhoma mbajtjeje, por janë jashtë funksioni. Personat e ndaluar mbahen për 6 orë, regjistrohen dhe në bashkëpunim me prokurorin procedohen tutje. Në rast të lëndimeve të të ndaluarve, dërgohen në ambulanten e qytetit.

Drejtoria Rajonale Kufitare “Lindje”, në Kaçanik, ka nën mbikëqyrje pjesën më të madhe të kufirit shtetëror me Republikës e Maqedonisë, si dhe një pjesë të kufirit shtetëror me Republikën e Serbisë, duke patrulluar dhe vëzhguar, pasi nuk ka objekt ku policët qëndrojnë. Sipas informatave, nuk ka pasur lëvizje ditëve të fundit dhe kryesisht këtë pikëkalim e shfrytëzojnë kontrabandistët, por jo edhe nga emigrantët.

Në kuadër të Policisë Kufitare që mbikëqyr Vijën e Gjellbër në Zhegër, u njoftuam nga rreshteri se punojnë 43 zyrtarë policorë dhe togeri e komandanti, prej tyre 5 janë femra, ndërsa 2 policë janë pensionuar. Nuk ka prurje të reja, ndërsa moshja mesatare e policëve është 40 vjeç.

Sipas rreshterit, nuk ka pasur furnizime me uniforma, por ka pasur furnizime me çizme, kanë në dispozicion dy vetura (për shkak të prishjeve, për 6 muaj kanë qenë pa vetura), kanë probleme me printer (kompania ArtHouse), sprej nuk ka afat që nga viti 2017, jelekët antiplumb kanë afat 3-vjeçar (varet nga prodhuesi), stacioni ka nevojë për rinovim, për shkak të mykut dhe kanë problem me insekte. Mirëpo problemet kryesore janë moshja e shtyrë, sigurimi shëndetësor dhe nevoja për trajtim psikologjik.

35. Gjatë vizitës në **Pikëkalimin Kufitar Stanqiq - Bellanoc** (Republika e Kosovës - Maqedoni e Veriut), u takuam me komandantin, nga i cili u njoftuam se kjo pikë kufitare

është lëshuar për qarkullim në vitin 2020, por vetëm për automjetet e vogla, e jo edhe për mallra. Sipas komandantin, kjo pikë nuk ka pasur kalime ilegale, por ka pasur raste arrestimi. Në këtë pikë punojnë 30 policë dhe 1 staf civil. Prej tyre janë 3 police dhe 4 policë të nacionalitetit serb. Mosha mesatare e policëve është 50 vjeç. Objekti është ndërtuar nga BE-ja dhe i plotëson të gjitha kushtet, përveç dy dhomave të ndalimit, të cilat, edhe pse janë të ndërtuara me standarde, ato janë në katin e tretë. Megjithatë, personat që ndalohen, regjistrohen dhe nuk mbahen më tepër se 6 orë, të cilët në bashkëpunim me prokurorinë procedohen tutje.

Në këtë objekt janë të vendosur edhe zyrtarët policorë të Maqedonisë së Veriut, që është e vetmja strukturë në tërë Kosovën, me të cilët kanë bashkëpunim shumë të mirë. Po ashtu, në këtë objekt janë edhe zyrat e Doganës. Gjatë vizitës u njoftuam se nuk ka zyrtar doganor në zyrën e Doganës së Kosovës, përderisa në atë të Maqedonisë së Veriut ishte zyrtari dhe na njoftoi se zyra punon 24 orë. Sipas komandantit, ka ndalje të rrymës dhe në ato raste, edhe pse ka gjenerator, nuk kanë ujë e as rrjet. Mirëmbajtja e objektit është me marrëveshje me palën maqedonase, një vit Kosova, një vit Maqedonia e Veriut. Kanë një veturë dhe një kombi, që i plotësojnë nevojat.

Ekipi vizitoi të gjitha hapësirat dhe vërejtë se janë të një standardi të lartë, kishin edhe tualet për persona me nevoja të veçanta, pastërtia ishte në nivel, kishte edhe pastrues të angazhuar nga kompania.

Me këtë rast u takuam edhe me palën maqedonase, të cilët i njoftuam me mandatin dhe arsyen e vizitës. Objekti i plotëson kushtet edhe për qarkullimin e mallrave, pasi kishin hapësirat për kontrole dhe matje, me ç' rast u pajtua edhe komandanti, pasi kjo pikë kufitare është më e shkurtër për qarkullim Gjilan – Kumanovë - Aeroport, sesa pika kufitare Hani i Elezit. U takuam edhe me policët në detyrë që kontrollonin pasaportat, e në momentin e vizitës ishte një polic serb dhe nga biseda me të kuptuam se sfidat e tyre ishin të ngjashme me policët e tjerë, si: mosha e shtyrë, me uniforma nuk ishin furnizuar që disa vite, por vetëm me çizme, sigurimi shëndetësor etj.

36. Gjatë vizitës në **Pikëkalimin Kufitar Vërmicë**, u takuam me kapitenin e pikës kufitare dhe me zëvendëskomandantin. Gjatë këtij takimi u diskutuan çështje të përgjithshme, sfidat dhe kushtet e punës në këtë pikë kufitare.

Objekti ku ndodhet pika kufitare menaxhohet nga Dogana e Shqipërisë, e cila ka marrë përsipër mirëmbajtjen e tij. Në këtë pikë është vendosur gjithashtu Policia e Frontex-it, e cila parashikon të sjellë edhe 30 zyrtarë policorë. Aktualisht në pikën kufitare janë të angazhuar 61 policë, përfshirë komandantin, nga të cilët 4 janë femra dhe 10 janë zyrtarë të rinj. Sipas komandantit, kushtet e punës janë të vështira gjatë të gjitha stinëve. Një nga problemet kryesore është mungesa e ujit, pavarësisht se ai është shpallur i pijshëm; shumë zyrtarë e blejnë atë.

Kjo pikë kufitare është vizituar edhe në tetorin e vitit të kaluar, në një takim të përbashkët të Avokatit të Popullit, UNHCR-së, Policisë së Shqipërisë, të cilët kanë vizituar edhe Pikën e Gjelbër. Në këtë vizitë Avokati i Popullit është njoftuar se do të fillojë ndërtimi i kabinave të reja për policinë.

Zyrtarët përballen edhe me sfida të tjera, përfshirë moshën e shtyrë, stazhin e shkurtër për pensionim dhe pensione shumë të ulëta. Pajisjet e punës, si: këpucët dhe jelekët

antiplumb, i posedonin, por zyrtarët e rinj, në kohën e vizitës nuk ishin pajisur plotësisht me mjetet e nevojshme, si: prangat dhe shkopinjtë.

Sigurimi i transportit për policët në vajtje-ardhje në punë ishte kërkesë e përgjithshme, gjë që është kërkuar të trajtohet me rekomandim.

Personat e arrestuar mbahen deri në 6 orë dhe nuk ka nevojë për dërgimin e tyre në Qendrën e Mbajtjes. Në rast nevojë për ndihmë mjekësore, ata kontaktojnë Emergjencën e Prizrenit, e cila vlerësohet si shumë efikase.

Komandanti ngriti shqetësime lidhur me hetimet ndaj policëve, të cilat shpesh rezultojnë pa prova të mjaftueshme. Ai theksoi nevojën që Avokati i Popullit ta mbrojë integritetin e policisë, sidomos në rastet e arrestimeve publike.

Ekipi vizitoi gjithashtu dhomat e mbajtjes, ku komandanti i stacionit policor, z. Latif Hoxha, na informoi se në Qendrën e Mbajtjes janë 4 dhoma, dy të Kosovës dhe dy të Shqipërisë. Dhomat nuk kanë kamera, por janë të pajisura me kushte minimale për mbajtje.

Në SPMK-së, janë të angazhuar 30 zyrtarë policorë, përfshirë një femër. Kushtet e punës janë të vështira, me mungesë investimesh dhe as furnizim me ujë të pijshëm. Stacioni ka tri vetura të vjetruara dhe ka dy vjet që nuk ka kapiten.

Ankesat e zyrtarëve policorë janë të ngjashme me ato të stacioneve të tjera të monitoruara. Megjithatë, policia kufitare ka nevojë për furnizime më të shpeshta me uniforma, siç ishte praktika në të kaluarën.

37. Gjithashtu, gjatë vizitës në **Pikëkalimin Kufitar Dheu i Bardhë**, në bashkëpunim me UNHCR-në dhe CRPK-në, takimi fillestar ishte me komandantin e pikës kufitare, i cili shpjegoi se objekti për zyrtarët policorë është pronë e Serbisë dhe është i vendosur përkohësisht pas marrëveshjes së Brukselit. Aktualisht Policia e Kosovës funksionon në këtë objekt të improvizuar (kontejner), për të cilin pala serbe është përgjegjës për pagesat dhe rinovimet, ndërsa interneti ofrohet nga pala kosovare.

Objekti ishte i vjetruar dhe kishte mungesë të ujit të pijshëm. Zyrtarët policorë shpesh merrnin ushqim nga shtëpitë e tyre ose me porosi nga restorantet. Në PKK ishin të angazhuar 50 zyrtarë policorë, përfshirë 3 të stafit civil, me një mesatare moshe që ishte ulur me ardhjen e gjashtë policëve të rinj. Në punën praktike ishin edhe 6 policë të diplomuar së fundmi. Nga komunitetet ishin 10 serbë, plus shefi i operativës dhe një turk, ndërsa 4 ishin femra. Orari i punës 8 dhe 12 orësh. Gjatë vizitës, ata morën këpucë dhe çizme, por kishin mungesë të furnizimit me uniforma.

PKK-ja kishte një veturë të vjetër dhe nuk ofronte transport për policët për vajtje-ardhje në punë. Një sfidë e madhe për ta ishte numri i lartë i personave në “Stop Listë”, që mbaheshin në kushte të papërshtatshme. Komandanti theksoi nevojën për një bashkëpunim më të ngushtë institucional dhe u ndanë broshura për informimin e zyrtarëve.

Gjatë vizitës, zyrtarët e UNHCR-së dhe të CRPK-së diskutuan për trajnime dhe planifikime të ardhshme, duke përfshirë përgatitjen e gjeneratave të reja të zyrtarëve policorë. Kjo vizitë nxori në pah nevojat dhe sfidat me të cilat përballen zyrtarët policorë

te Dheu i Bardhë, duke kërkuar përmirësime në kushte dhe mbështetje më të madhe për ta.

38. Në shumicën e pikëkalimeve kufitare dhe stacioneve policore, mungonin informatat mbi të drejtat e njeriut, statusin ligjor, të drejtat e të ndaluarve, si dhe të drejtën për t'i kontaktuar mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Kujdesi shëndetësor

39. Për sa u përket shërbimeve mjekësore, si e drejtë themelore, personave të cilët ndalohen nga policia, këto shërbime u ofrohen nga institucionet publike, siç janë: qendra e mjekësisë familjare dhe Qendra Klinike Universitare, varësisht nga nevojat për trajtim. Nga dokumentacioni i shqyrtuar është vërejtur se policia ka evidentuar në dosjet e tyre personale njoftimin për të drejtën për të pasur shërbime mjekësore.

Ushqimi

40. Neni 168, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Penale përcakton se personit të ndaluar për më shumë se dymbëdhjetë (12) orë, i sigurohen tri (3) racione ushqimi në ditë. Kurse personit të ndaluar në kohëzgjatje më pak se dymbëdhjetë (12) orë, i sigurohet një racion ushqimi për çdo katër (4) orë të ndalimit.
41. Në pikat kufitare, ushqimi nuk ofrohet për individët e ndaluar, duke pasur parasysh kohën e shkurtër të mbajtjes (6-7 orë). Stafi i kufirit ka arritur të gjente forma alternative të ofrimit të ushqimit, por largësia e pikave kufitare nga vendet e banuara paraqet sfida të konsiderueshme. Në këtë kontekst, gjatë një vizite të realizuar nga MKP-ja më 27 prill 2024, ku ishin të pranishëm Avokati i Popullit dhe shefi i UNHCR-së, zyrtarët policorë në Kullë kërkuan ndihmën e UNHCR-së për sigurimin e ushqimit të paketuar për stafin e pikëkalimit kufitar, por edhe për personat e ndaluar.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

42. Avokati i Popullit nga të gjeturat konstaton se SPMK-Jarine dhe pikëkalimet kufitare Kulla dhe Dheu i Bardhë janë të vendosur në kontejnerë, të cilët janë të vjetër, e të cilët mund të paraqesin rrezik për shëndetin e zyrtarëve policorë dhe nuk përmbushin kushtet për kryerjen e detyrave të punës.
43. Avokati i Popullit konstaton se në shumicën e pikëkalimeve kufitare dhe të stacioneve policore të lartcekura ka mungesë dhe defekte të vazhdueshme në sistemin e fotokopjeve, që çojnë në vonesën e procedimit të raporteve dhe të rasteve duke vështirësuar punën e policisë.
44. Avokati i Popullit nga të gjeturat konstaton se në pikën e kalimit kufitar në Merdare nuk është e angazhuar asnjë zyrtarë policorë, duke detyruar transportimin e një zyrtareje nga Stacioni Policor i Podujevës. Ky proces jo vetëm që shkakton kosto të shtuar, por gjithashtu vonon procedurat, duke e bërë përvojën e kalimit kufitar më të vështirë për të gjitha palët e përfshira.
45. Avokati i Popullit vëren se në pikat e kalimit kufitar, mosha mesatare e zyrtarëve policorë është e lartë.
46. Avokati i Popullit konstaton se në pikat e kalimit kufitar Kllokot, Staniqiq-Bellanocë, Dheu i Bardhë dhe SPMK-Jarine nuk ka pasur furnizim me uniforma të reja për zyrtarët policorë.

47. Avokati i Popullit konstaton se në Stacionin Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjellbër në Kllokot, dhomat e ndalimit janë jofunksionale, duke përbërë një shkelje të procedurave të duhura dhe një sfidë për zyrtarët policorë. Mungesa e këtyre dhomave krijon vështirësi në menaxhimin e situatave ku nevojitet ndalimi i udhëtarëve, duke rritur rrezikun e shkeljeve të drejtave të njeriut dhe duke e bërë më të vështirë punën e policisë.
48. Avokati i Popullit ka vërejtur se në Stacionin Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjellbër në Kllokot ka vetëm dy automjete shumë të vjetra, të cilat janë të pamjaftueshme për nevojat operative. Këto automjete shpesh kanë probleme teknike, duke shkaktuar ngecje në kryerjen e detyrave të punës. Kjo situatë e dëmton efikasitetin e operacioneve të policisë kufitare dhe rrit rrezikun për vonesa në proceset e kontrollit.
49. Avokati i Popullit, në pikat e kalimit kufitar në Vermicë dhe në Dheun e Bardhë, ka pranuar shqetësime nga zyrtarët policorë në lidhje me problemet e transportit për vajtje-ardhje. Këto vështirësi në transport ndikojnë negativisht në disponueshmërinë e zyrtarëve për të kryer detyrat e tyre, duke krijuar vonesa dhe pengesa në operacionet e përditshme.
50. Ndërsa për sa i përket funksionalizimit të kamerave në qendrat e mbajtjes, Avokati i Popullit vëren se në Pikëkalimin Kufitar në Vermicë, kamerat e sigurisë nuk janë funksionale. Avokati Popullit konstaton se mosfunksionalizimi i kamerave në pikëkalimin kufitar në fjalë paraqet rrezik për keqtrajtim të personave në ndalim, por në anën tjetër janë garanci shtesë për punën e policisë.
51. Në shumicën e pikave të kalimit kufitar dhe në stacione policore mungonin informatat për të drejtat e njeriut, për statusin ligjor, për të drejtat e të ndaluarve, si dhe për të drejtën për t'i kontaktuar mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit konstaton se kjo mund të krijojë një situatë ku individët që ndodhen në kushte të ndalimit ose të kontrollit mund të mos jenë të informuar për të drejtat e tyre ligjore dhe mund të mos e kenë mundësinë të kërkojnë ndihmë për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Përshtatja e informacioneve të tilla në këto vendndodhje është e rëndësishme për të siguruar transparencë dhe respektimin e të drejtave të njeriut në çdo fazë të procesit të ndalimit ose të inspektimit.
52. Avokati i Popullit konstaton se në të gjitha pikat e kalimit kufitar të vizituara (përveç Jarines) kanë probleme me sigurimin e ushqimit, si për stafin, ashtu edhe për personat e ndaluar.

Prandaj, bazuar në të gjeturat gjatë vizitës nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Policisë së Kosovës:

- 1. Investime për krijimin e kushteve adekuate të punës për personelin dhe përmirësimin e infrastrukturës në SPMK - Jarine.*
- 2. Investime për krijimin e kushteve adekuate të punës për personelin dhe përmirësimin e infrastrukturës në Pikëkalimin Kufitar Dheu i Bardhë.*
- 3. Investime për krijimin e kushteve adekuate të punës për personelin dhe përmirësimin e infrastrukturës në Pikëkalimin Kufitar Merdare.*
- 4. Të sigurohet një furnizim i qëndrueshëm dhe i rregullt i tonerëve dhe i materialeve të nevojshme për operimin e pajisjeve të fotokopjimit, printimit dhe të*

ketë mbështetje teknike të vazhdueshme për riparimin e printerëve dhe fotokopjuesve në të gjitha pikëkalimet kufitare dhe në stacionet policore të vizituara. Gjithashtu, të vlerësohet performanca e kompanisë e cila është e angazhuar për mirëmbajtjen e fotokopjeve.

5. Të angazhohen zyrtare policore në Pikëkalimin Kufitar Merdare.
6. Shtim i stafit të ri policor në të gjitha pikëkalimet kufitare.
7. Furnizimi i menjëhershëm me uniforma të reja për zyrtarët policorë në të gjitha pikat e kalimit kufitar dhe në stacionet policore.
8. Rikthimi në funksion i dhomave të ndalimit në Stacionin Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjelbër në Kllokot.
9. Të sigurohen automjete të reja dhe funksionale në Stacionin Policor për Mbikëqyrje të Vijës së Gjelbër në Kllokot.
10. Sigurimi i një transporti të qëndrueshëm dhe të rregullt për zyrtarët policorë në Pikëkalimin Kufitar në Vërmicë.
11. Sigurimi i një transporti të qëndrueshëm dhe të rregullt për zyrtarët policorë në Pikëkalimin Kufitar Dheu i Bardhë.
12. Të funksionalizohen kamerat e sigurisë në dhomat e ndalimit në Pikëkalimin Kufitar në Vërmicë.
13. Hapësirat e mbajtjes (ndalimit) në pikat e kalimit kufitar të pajisen me informata relevante në gjuhë të ndryshme (broshura dhe poster) përmes të cilave personat e ndaluar njoftohen për të drejtat e tyre, për statusin e tyre ligjor, si dhe për të drejtën për të kontaktuar me mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
14. Pikëkalimi Kufitar në Kullë të ketë një sistem të plotë dhe të standardizuar për regjistrimin e të dhënave të personave të ndaluar.
15. Të gjendet zgjidhje për furnizim me të qëndrueshëm me ushqim në të gjitha pikat e kalimit kufitar.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

